



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ /2018

V E N D I M

Nr. 64 , Datë 15 / 03 / 2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 38, datë 13.07.2017, të paraqitur nga Shoqata “Lëvizja Rinore Egjiptiane-Rome”, kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “Racës”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Subjekti ankues në informacionin e dhënë në ankesë shpjegon se, në Shkollën 9-vjeçare “Stavri Themeli” Korçë zbatohet programi i shansit të dytë. Në këtë shkollë janë gjithsej 14 nxënës¹ që e frekuentojnë këtë program, 9 nxënës i përkasim komunitetit egjiptian dhe 5 nxënës i përkasin komunitetit rom. Shoqata informon se nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale, Korçë nuk janë marrë masa për shmangien e klasës së segreguar me nxënës të komunitetit rom dhe egjiptian në kundërshtim dhe me rekomandimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit për shkak të racës, në fushën e arsimit të nxënësve të komunitetit rom/egjiptian nga ana e MAS dhe DAR Korçë, për krijimin e situatës së segregimit dhe veçimit të nxënësve rom dhe egjiptian në shkollën 9-vjeçare “Stavri Themeli” dhe marrjen e masave të nevojshme për ndalimin e kësaj situate.

Bazuar në nenin 33/1 të ligjit nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, kanë të drejtë të paraqesin ankesë para Komisionerit edhe organizatat me interesa legjitime që pretendojnë

¹ Referuar shkresës nr.550, datë 27.06.2017 të DAR Korçë drejtuar shoqatës “Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome”.

diskriminim në emër të disa personave. Në bazë të nenit 3/9 të ligjit nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, “organizatat me interesa legjitime”, janë ato organizata të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit. Sa më sipër, Komisioneri konstaton se subjekti ankues “Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome”, legjitimohet për të paraqitur ankesë përpara Komisionerit, si një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim për një grup personash. Si pasojë ankesa iu nënshtrua shqyrtimit të plotë.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi për shkak të racës është shkak i cili gëzon mbrojtje nga ligji dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 703/1, datë 20.07.2017 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjekteve, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga subjekti ankues.

Me shkresën nr. 622, datë 25.07.2017, Drejtoria Arsimore Rajonale, Korçë informon Komisionerin se: “Shkolla 9-vjecare “Stavri Themeli” Korçë është shkolla e caktuar për pranimet e nxënësve që ndjekin arsimin bazë me kohë të pjesshme sipas Udhëzimit nr.29, datë 02.08.2013 “Procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme”. Pjesë e këtij udhëzimi është dhe procedura e ndjekjes së shansit të dytë, ku parashikohet se regjistrohen të gjithë fëmijët

e moshës së detyrimit shkollor që kanë braktisur shkollën, e ndërpresin ose nuk e kanë ndjekur dhe nuk kthehen në shkollën bazë me kohë të plotë dhe as nuk ndjekin shkollën bazë me kohë të pjesshme, kanë të drejtë të ndjekin shkollimin e quajtur shansi i dytë. Pra, kuptohet se hapja e vazhdimi i programit shansi i dytë është një detyrim ligjor që jep mundësinë për të gjithë ata nxënës që kanë kaluar moshën për të ndjekur arsimin bazë me kohë të plotë dhe s'kanë ndjekur arsimin bazë me kohë të pjesshme. Në këtë program mund të regjistrohen të gjithë ata që nuk kanë mundur të mbarojnë arsimin bazë nga të gjitha komunitetet dhe fakti se janë regjistruar nxënës të komunitetit rom dhe egjiptian nuk do të thotë se DAR Korçë ka ndërmarrë hapa për të regjistruar vetëm nxënës të këtyre komuniteteve apo ka neglizhuar në ndonjë formë duke segreguar nxënës të këtij komuniteti. Ju sqarojmë se është praktikisht e pamundur të parashikosh komunitetin e nxënësve që do të regjistrohen në këtë program pasi ky program është i hapur për të gjithë ata që plotësojnë kriteret.

Me shkresën nr. 7319/1, datë 18.09.2017, Ministria e Arsimit dhe Sportit, informon Komisionerin se: *“Në shkollën 9-vjecare “Stavri Themeli” Korçë ofrohet edhe arsimi bazë me kohë të pjesshme për të gjithë individët që nuk kanë mundur të përfundojnë arsimin e detyruar brenda moshës së caktuar me ligj. Gjatë vitit shkollor 2016-2017, në asnjë nga shkollat 9-vjeçare në juridiksionin e DAR Korçë nuk ka pasur klasa të shansit të dytë. Arsimi bazë me kohë të pjesshme ofrohet vetëm për individët që kanë kaluar moshën e detyrimit shkollor dhe ndjekja e kësaj forme arsimimi është e lirë, pa detyrim. Çdokush që dëshiron të plotësojë arsimin e detyruar, pranohet në arsimin bazë me kohë të pjesshme, pavarësisht nga mosha madhore”.*

- Me shkresën nr. 703/4, datë 21.09.2017 i është kërkuar informacion shtesë subjektit, DAR Korçë, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga subjekti ankues.

Me shkresën nr. 770, datë 28.09.2017, Drejtoria Arsimore Rajonale, Korçë informon Komisionerin se: *“Tek shkolla 9-vjecare “Stavri Themeli”, pavarësisht faktit se përdoret kurrikula e programit shansi i dytë, tek kjo shkollë nuk ka klasa të këtij programi por përdoret kurrikula e miratuar për shansin e dytë tek shkolla 9-vjecare me kohë të pjesshme. Për vitin shkollor 2015-2016 dhe 2016-2017 nuk ka klasa të shansit të dytë në rrethin e Korçës, por më përpara ka pasur tek shkolla e mesme e bashkuar “Bardhyl Pojani” Pojan. Këta nxënës janë integruar me klasat e tjera dhe vazhdojnë mësim sipas klasave të caktuara duke bërë kështu prej dy vitesh. Për vitin shkollor 2014-2015, gjithsej në shkollën Pojan ishin 9 nxënës, 7 të komunitetit egjiptian, 1 të komunitetit rom dhe 1 të maxhorancës të cilët të gjithë janë integruar në klasat respektive dhe vazhdojnë mësim si gjithë nxënësit e tjerë. Programi shansi i dytë ka disa vite që nuk zbatohet më, me qëllim integrimin dhe gjithë përfshirjen e këtyre nxënësve në klasat normale”.*

Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr. 117, datë 05.10.2017 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit pranë DAR Korçë”,

inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë DAR Korçë, më datë 09.10.2017, për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit pranë DAR Korçë, inspektorët e KMD-s, morën takim me M.K, me detyrë Jurist pranë këtij institucioni dhe S.M me detyrë Drejtor i shkollës “Stavri Themeli”.

Gjatë inspektimit M.K informoi se: *“Në lidhje me informacionin e dhënë me shkresën nr.550, datë 27.06.2017, ju informoj se ka qenë një lapsus, pasi në shkollën “Stavri Themeli” nuk zhvillohet mësim për nxënësit shansi i dytë, por frekuentohet nga nxënës të shkollës me kohë të pjesshme. Shkolla me kohë të pjesshme ka të regjistruar gjithsej 163 nxënës, por frekuentohet vetëm nga 14 nxënës të shpërndarë nga klasa e parë në të nëntë. Këto nxënës janë të shpërndarë sipas klasave dhe nuk e ndjekin mësimin të gjithë bashkë. Gjatë vitit shkollor 2014-2015 në shkollën “S.Themeli” me kohë të pjesshme janë regjistruar gjithsej 160 nxënës dhe e kanë frekuentuar 20 nxënës të shpërndarë në klasa të ndryshme, ndërsa në vitin 2015-2016 janë regjistruar 162 nxënës dhe e kanë frekuentuar shkollën 18 nxënës.*

Gjatë inspektimit ...M informoi se: *“Në shkollën “Stavri Themeli” nuk ka klasa dhe nxënës të shansit të dytë, por është shkollë që zhvillohet mësimi për nxënësit me kohë të pjesshme. Që nga viti shkollor 2014-2015 nxënësit me kohë të pjesshme kanë ndjekur planin mësimor për nxënësit shansi i dytë, pasi nuk kishte programe të tjera mësimore. Nxënësit e frekuentojnë mësimin sipas klasave dhe nuk janë të grupuar sipas komuniteteve”.*

Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e administruar gjatë inspektimit, rezulton se në tabelën² e frekuentimit të mësimit të nxënësve me kohë të pjesshme të shkollës “S.Themeli” figurojnë të dhënat e mëposhtme si dhe informacioni se nga 14 nxënësit që frekuentojnë shkollën me kohë të pjesshme 10 prej tyre kanë deklaruar se i përkasin komunitetit rom ose egjiptian ndërsa 4 nxënës të tjerë kanë refuzuar të deklarojnë përkatësinë e tyre etnike.

Klasa	Nxënës të regjistruar	Nxënës frekuentues
1	0	0
2	0	0
3	3	0
4	3	0
5	15	2
6	24	1
7	40	4
8	41	4
9	37	3
Gjithsej	163	14

² Email datë 31.08.2017 dërguar nga DAR Korçë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Në analizë të legjislacionit dhe dokumenteve të shqyrtuara, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vlerëson se:

- I. Lidhur me pretendimin për segregim të nxënësve rome dhe egjiptian në shkollën “Stavri Themeli” Korçë, Komisioneri gjykon se:

Në shkollën 9-vjecare “Stavri Themeli” Korçë ofrohet arsimit bazë me kohë të pjesshme për të gjithë nxënësit që kanë kaluar moshën e detyrimit shkollor dhe nuk kanë përfunduar arsimin bazë me kohë të plotë dhe nuk ka klasa në të cilën zhvillohet mësimi për nxënësit që ndjekin shkollimin e quajtur “shansi i dytë”.

Informacioni i dhënë nga DAR Korçë dhe shkolla “Stavri Themeli” në lidhje me segregimin e nxënësve që ndjekin shkollimin shansi i dytë ka qenë i pasaktë dhe jo i plotë në drejtim të informimit të institucioneve dhe shoqatës “Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome” mbi frekuentimin e shkollës nga ana e nxënësve të komunitetit rom dhe egjiptian pasi në shkollën “S.Themeli” Korçë nuk ka klasa të shansit të dytë.

Nga korrespondenca e mbajtur mes DAR-it Korçë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës³ dhe nga shkresa nr.770, datë 28.09.2017 e DAR Korçë drejtuar Komisionerit, verifikohet se në shkollën “Stavri Themeli” për vitet shkollore 2014-2015, 2015-2016 dhe 2016-2017 nuk ka patur klasa në të cilën të zhvillohej, shkollimi i quajtur “shansi i dytë” por ka patur klasa në të cilën zhvillohej mësimi për nxënësit me kohë të pjesshme.

Sipas informacionit të administruar gjatë procedurave të hetimit administrativ, rezultoi se në vitin shkollor 2016-2017, në programin e arsimit me kohë të pjesshme kanë qenë të regjistruar 163 nxënës dhe kanë frekuentuar mësimin 14 prej tyre. Nga nxënësit që frekuentonin shkollën 10 prej tyre kanë vetëdeklaruar që i përkasin komunitetit rom ose egjiptian dhe për 4 nxënës nuk ka të dhëna se cilit komunitet i përkasin.

Në Udhëzimit nr. 29, datë 02.08.2013, “Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme”, përcaktohet se shkolla me kohë të pjesshme funksionon tri ditë në javë dhe kanë të drejtë të regjistrohen nxënësit që kanë mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nuk kanë përfunduar arsimin bazë me kohë të plotë.

Referuar dokumentacionit të administruar vlerësohet se mësimi për klasat e mësimin me kohë të pjesshme zhvillohet i ndarë sipas klasave dhe mësimi frekuentohet nga nxënësit e regjistruar pavarësisht komunitetit të cilit i përkasin. Për vetë specifikën e shkollës me kohë të pjesshme, nga ana e shkollës nuk mund të planifikohet se cilët nxënës do frekuentojnë mësimin pasi ndjekja e mësimin është e lirë, pa detyrim dhe nuk ekziston mundësia e segregimit të nxënësve të komunitetit rom/egjiptian pasi është detyrim ndjekja e mësimin sipas klasave, pavarësisht numrit të nxënësve që frekuentojnë mësimin.

³ Informacion me email dërguar nga DAR Korçë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës datë 31.08.2017.

Referuar informacionit të dhënë nga MAS dhe dokumentacionit të administruar nga Komisioneri gjatë inspektimit të datës 09.10.2017, Komisioneri vlerëson se veprimet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, DAR-it Korçë dhe shkollës “Stavri Themeli” në drejtim të frekuentimit të shkollës me kohë të pjesshme dhe ndarjes në klasa të nxënësve të komunitetit rom dhe egjiptian nuk kanë qenë diskriminuese pasi zbatimi i legjislacionit në lidhje me procedurat për ndjekjen e arsimit bazë me kohë të pjesshme nuk përbën trajtim më pak të favorshëm dhe diskriminues.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1/a) dhe c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të nxënësve të komunitetit rom/egjiptian të shkollës me kohë të pjesshme “Stavri Themeli” nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë, për shkak të “racës”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

(shkaku: raca)
(fusha: arsim)